



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1872 Prot.

Tiranë, më 10 / 12 / 2019

**V E N D I M**

**Nr. 183, Datë 10 / 12 / 2019**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr.67 Regj., datë 07.06.2019, të F. P, kundër Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR) Shkodër dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), me pretendimin e diskriminimit për shkak të “*bindjeve politike*<sup>1</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, F. P ka qenë i punësuar pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR) Shkodër dhe ka mbajtur detyrën e Kryetarit të Degës së Financës, nga data 04.08.2015 deri me datë 26.12.2018.

Subjekti ankues është shprehur se, në muajin Gusht 2018 pranë DRSHTRR Shkodër është paraqitur Grupi i Drejtorisë së Investigimit Administrativ, me qëllim investigimin e përjashtimit nga pagesa e taksave për mjetet në pronësi të personave me aftësi të kufizuar. Z.P ka theksuar se ky grup pune nuk ka patur asnjë urdhër shkresor lidhur me investigimin e kryer dhe se ai nuk

---

<sup>1</sup> Referuar dokumentacionit provues bashkëngjitur ankesës, subjekti ankues ka konkuruar si kandidat për deputet i subjektit politik “Aleanca Kuq e Zi” në listën shumëemërore të zgjedhjeve për Kuvendin /2013.

<sup>2</sup>Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

është lejuar të ishte i pranishëm gjatë kontrollit të ushtruar. Në përfundim të këtij kontrolli ky grup ka dalë me një raport, me të cilin ankuesi pretendon se nuk është njohur asnjëherë.

Ai gjithashtu, thekson se në rrugë konfidenciale ka mësuar se sipas këtij raporti rreth 300 persona ishin konsideruar si përfitues të paligjshëm, me një efekt dëmi financiar prej 1.016.482 lekësh dhe se ndaj tij ishte propozuar ndjekje penale.

Z.P citon se me datë 26.09.2018 është njohur me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të DPSHTRR për pezullimin e tij nga detyra dhe fillimin e misionit të auditimit nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të DPSHTRR. Ai pretendon se edhe gjatë punës së këtij misioni nuk është lejuar të jetë i pranishëm apo të japë sqarime, informacion si subjekt që po auditohej, duke vënë theksin tek fakti se ai ishte i vetmi punonjës, objekt i këtij procesi. Në përfundim të auditimit ankuesi është njohur me raportin e hartuar dhe me datën për takim e ballafaqimit të pretendimeve. Sipas shpjegimeve të ankuesit në takim kanë marrë pjesë: ankuesi personalisht, Drejtorja e DRSHTRR dhe Drejtorja e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm. Ai ka kundërshtuar raportin e hartuar si dhe ka kërkuar që të merrej informacion i saktë pranë institucioneve përgjegjëse: Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, lidhur me dokumentacionin e lëshuar prej tyre për personat me aftësi të kufizuar, pasi rreth 15 persona megjithëse kishin paraqitur dokumentacionin e kërkuar pranë Degës së Financës, nuk figuronin në regjistrin elektronik të atyre insitucioneve. Procesverbali i mbajtur në takim ka qenë i njëanshëm dhe nuk pasqyronte problematikën e detajuar të takimit.

Tre muaj pas pezullimit nga detyra, me Urdhërin e datës 26.12.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPSHTRR, F. P i janë ndërprerë në mënyrë të menjëhershme marrëdhëniet e punës, me motivacionin e shkeljes financiare dhe dëmit ekonomik të shkaktuar.

Ankuesi pretendon se i gjithë procesi i iniciuar ndaj tij ka qenë tendencioz dhe i qëllimshëm, pa asnjë shkak ligjor dhe i pabazuar në fakte, prova dhe argumenta ligjorë; por vetëm për faktin se ai nuk është pjesë e strukturave të PS. Ai provon dhe dokumenton bindjet e tij politike si anëtar i Partisë Aleanca Kuq e Zi. Nga viti 2012 e në vijim ka kryesuar degën e kësaj partie në Shkodër. Po ashtu, në zgjedhjet politike të vitit 2013 ka qenë kandidat për deputet i kësaj partie. Subjekti ankues citon se për shkak të angazhimit të tij politik edhe në vitin 2013 është larguar nga puna, me të njëjtin skenar dhe e ka fituar çështjen në dy shkallë gjykimi duke u rikthyer në të njëjtin pozicion pune, si Kryetar i Degës së Financës pranë DRSHTRR Shkodër, me datë 04.08.2015. Ai thekson faktin se nuk ka marrë asnjë vërejtje lidhur me punën e kryer prej tij, përkundrazi është vlerësuar për performancën e tij.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjeve të tij politike, nga ana e punëdhënësit dhe rikthimin në vendin e punës.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së<sup>3</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

**Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.**

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij dhe janë brenda afateve ligjore, të parashikuara nga ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr.876/2 prot., datë 14.06.2019 nga ana e KMD i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues DPSHTRR dhe DRSHTRR Shkodër, lidhur me pretendimin e ankuesit.
- Me shkresën me nr. prot.2347, datë 25.06.2019, DRSHTRR Shkodër informon Komisionerin se, procedura e ndërprerjes së marrëdhënies së punës me F. P është mbështetur në ligj, fakte dhe prova.

DPSHTRR ka marrë vendimin e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës me këtë punonjës, pas Raportit Final të Auditit të Brendshëm, i cili rekomandoi që të rishikohen marrëdhëniet financiare me këtë punonjës për shkak të moszbatimit në mënyrë të përsëritur të detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren përkatëse të DPSHTRR duke shkaktuar një dëm financiar prej 1.016.482 lekësh.

---

<sup>3</sup>Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

DRSHTRR Shkodër ka shpjeguar në mënyrë të hollësishme se:

*“Me datë 27.08.2018 në DRSHTTR Shkodër është paraqitur Grupi i Investigimit të DPSHTTR me objekt investigimin e dokumentacionit të invalidëve të cilët përfitojnë përjashtim nga TVMP-ja për vitin 2017 e deri në Qershor 2018, për të cilat janë mbajtur procesverbalët përkatës të depozituar në dosje në cilësi prove. Për periudhën 2017-2018 rezulton se janë kontrolluar 199 raste për vitin 2017 dhe 107 raste për vitin 2018.*

*Nëpërmjet shkresës me nr.19693 prot., datë 15.11.2018 DRSHTTR Shkodër është njohur me Raportin Final të Auditimit, i cili ka konstatuar një dëm ekonomik të shkaktuar në shumën 1.016.482 lekë nga përjashtimi i TVMP-së së kategorisë së inavlidëve, për shkak të moszbatimit në mënyrë të përsëritur të detyrave funksionale në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloren e institucionit nga F. P, si dhe është rekomanduar rishikimi i marrëdhënieve të punës me këtë punonjës. Dokumentacioni i dorëzuar nga invalidët të cilët përjashtohen nga pagesa e TVMP-së, është dorëzuar fotokopje, i panjësuar me origjinalin, dhe është pranuar dhe administruar si i tillë nga Kryetari i Degës së Financës, z.P, i cili pasi mbante dokumentacionin, e pajiste “Invalidin” me nje vërtetim “Mbi përjashtimin nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura” të hartuara nga vetë ky i fundit, për t’u paraqitur tek punonjësit e arkës së subjektit si person i përjashtuar nga pagesa e TVMP-së.*

*Në procesverbalin me nr.3570 prot., datë 31.08.2018 vetë z.Paja ka pohuar se këtë vërtetim e ka lëshuar që nga viti 2000”.*

Për sa mësipër, DRSHTTR Shkodër, thekson faktin se, subjekti ankues, në cilësinë e Kryetarit të Degës së Financës, siç vërtetohet dhe nga vetëdeklarimet e tij, në mënyrë të vazhdueshme, pa autorizim nga Drejtoria, pas kontrollit të dokumentacionit në formën e një fotokopjeje të thjeshtë ka mbajtur në mënyrë individuale një vërtetim për përjashtimin nga TVMP-ja. Sipas Rregullores së Brendshme të DPSHTTR-së dhe Raportit të Auditit për kryerjen e këtij shërbimi është ngarkuar posti i faturuesit ose arkëtarit, ndërsa Kryetari i Degës së Financës ka rol kontrollues.

Bazuar në sa mësipër, DRSHTTR Shkodër ka arsyetuar se shkaktimi ndaj shtetit i një dëmi financiar prej 1.016.482 lekësh interpretohet si faj i rëndë. Pikërisht për këtë arsye, nëpërmjet shkresës me nr.20310/1, datë 14.12.2018 “Për fillimin e bisedimeve për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës”, DPSHTTR ka njoftuar z.P për t’u paraqitur për bisedime të mëtejshme pranë DPSHTTR me datë 20.12.2018.

Me datë 20.12.2018 është mbajtur takimi lidhur me bisedimet për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me z.P, ku të dyja palët kanë shprehur pretendimet lidhur me rishikimin e kësaj marrëdhënieje pune, fakt i cili reflektohet në procesverbalin e mbajtur në takim. Ndërkaq, në vijim të këtij takimi, nëpërmjet shkresës me nr.20310/3 prot., datë 26.12.2018, Urdhër nr.1430 “Për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës pa shkaqe të justifikuara” janë zgjidhur marrëdhëniet e punës me ankuesin<sup>4</sup>.

---

<sup>4</sup> Bazuar në citimet e DRSHTTR Shkodër, specifikisht: nenin 37, 153 të Kodit të Punës, Statutit të DRSHTTR Shkodër, shkresën me nr.20004 prot., datë 20.11.2018 Vendim “Për miratimin e memorandumit të përgatitur nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm mbi misionin e auditimit të pjesshëm në DRSHTTR Shkodër” shkresën me Adresa: Rruga e Durrësit, Kodi postar 1001, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

Për gjithë sa më sipër, DRSHTRR Shkodër ka argumentuar se zgjidhja e marrëdhënies së punës me ankuesin është bërë duke respektuar afatet e njoftimit, procedurën e zgjidhjes së kontratës së punës, dhe vetëm bazuar në ligj, duke respektuar gjithashtu personalitetin, interesat dhe të drejtat e tij si punëmarrës, edhe pavarësisht dëmit ekonomik të shkaktuar prej tij. Në vijim të kësaj logjike, DRSHTRR Shkodër citon se: *“Pretendimi i ankuesit se procesi i zhvilluar ndaj tij është tendencioz apo i qëllimshëm, nxitur nga arsye politike nuk qëndron për këto arsye:*

*Mbështetur në Rregulloren “Për Organizimin dhe Funksionimin e DPSHTRR me nr.778, datë 19.06.2018, neni 21 citon se, Drejtoria e Investigimit Administrativ, ka si mision të kryejë verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë dhe/ose kallëzimeve për praktika abuzive, korruptive e arbitrare, të identifikojë punonjësit e administratës së DPSHTRR-së, të cilët me veprime apo mosveprime kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, të përgatisë rekomandime për çështje, përfshirë dhe llojin e masave ndaj autorëve, si dhe të ndërjegjësojë institucionet publike në luftën kundër korrupsionit. Ajo ushtron veprimtarinë duke përdorur forma, metoda e mjete pune informative, të hapura e të mbyllura, të mbështetura në ligj, sipas standarteve të ngarkuara në ligji. Këto procedura miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili kërkon shpjegime për mënyrën e zbatimit të tyre”.*

DRSHTRR Shkodër ka informuar gjithashtu Komisionerin se, që nga data 10.01.2018 pranë DRSHTRR Shkodër është komunikuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër që po zhvillohen hetime të procedimit penal, një pjesë e të cilit kanë të bëjnë me përgjashtimet e kategorisë së invalidëve nga TVMP-ja, duke cituar se: “Nga ana jonë është kërkuar në rrugë zyrtare informacion për fazën në të cilën ndodhet hetimi apo gjykimi, por na është kthyer përgjigje se është regjistruar procedimi penal me nr.1819, i vitit 2017 për veprat penale të “Shpërdorimit të Detyrës”, parashikuar nga neni 248 I Kodit Penal dhe veprën penale të “Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike”, dhe ndodhet akoma në fazën e hetimeve”.

Bazuar në gjithë sa parashtrohet më sipër, DRSHTRR Shkodër sqaron se nuk ka patur as tendencë, as paligjshmëri sa i takon zgjidhjes së marrëdhënies së punës me z.P dhe aq më tepër që kjo të ketë ardhur për shkak të bindjeve të tij politike. E gjithë procedura është bazuar në fakte, dokumentacion dhe në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së F. P, Komisioneri me datë 11.09.2019<sup>5</sup> realizoi një seancë dëgjimore me palët në proces.

Seanca u zhvillua me praninë e të dy palëve në proces: subjektit ankues, personalisht, dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësuesve me autorizim<sup>6</sup> të DPSHTRR Tiranë dhe DRSHTRR Shkodër, znj.XH.M, znj.L.K dhe znj.K.P.

---

nr.20310/1 prot., datë 14.12.2018 “Njoftim mbi fillimin e bisedimeve për ndërprerjen e marrëdhënies së punës” dhe shkresën me nr.20310/2 prot., datë 20.10.2018 “Procesverbal”.

<sup>5</sup> Referuar “Njoftimit për seancë dëgjimore” me nr.876/4 prot., datë 30.08.2019.

Adresa: Rruga e Durrësit, Kodi postar 1001, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

Gjatë seancës dëgjimore, të dyja palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në. Nga ana e ankuesit u theksua fakti se procedura e ndjekur për largimin e tij ishte e padrejtë dhe se ai nuk ishte njohur me raportin e Auditit dhe gjetjet e tij.

U la si detyrë që në vijim nga DPSHTRR të silleshin parashtrime dhe dokumentacion mbi numrin e të larguarve nga puna për shkak të gjetjeve në shkelje nga ana e Auditit, në kushte të njëjta apo të ngjashme me ankuesin.

Në vijim të detyrave të lëna gjatë seancës, me anë të e-mailit të datës 24.10.2019, DPSHTRR ka dërguar parashtrimet e veta, duke cituar se: *“F. P është liruar nga detyra me datë 26.12.2018 nga raporti i auditimit në të cilin është konstatuar se pas kontrollit të ushtruar rezultoi se “pranimi dhe kontrolli i dokumentacionit për “invalidët” është kryer dhe depozituar nga K/Degës së Financës F. P duke pajisur invalidin me një vërtetim tip për arkën e subjektit “mbi përjashtimin nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura”. Për kryerjen e këtij shërbimi është i ngarkuar me rregullore posti i “faturuesit apo arkëtarit të taksave”. KIDegës së Financës ka rolin kontrollues mbi realizimin e detyrave funksionale të secilit punonjës” dhe si pasojë e këtyre shkeljeve ka ardhur një dëm ekonomik i konsiderueshem në dëm të DPSHTRR-së dhe DRSHTRR-së Shkodër. Sipas auditit, kjo ka ardhur si pasojë e moszbatimit të detyrave funksionale për çdo post pune të përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të DPSHTRR-së. Pra sjellimin në vëmendjen tuaj që në lidhje me diskriminimin e pretenduar nga z.P për shkak të arsyeve politike, në asnjë moment DPSHTRR-ja nuk ka pasur një synim të tillë (të ndërpresë marrëdhëniet e punës për shkak të bindjes politike. Gjithashtu DPSHTRR-ja, në vijim të objektit të kontrollit të Drejtorisë së Auditimit në DPSHTRR në Drejtorinë Rajonale, ka ushtruar kontroll dhe në Drejtori të tjera Rajonale dhe në konstatimet e Raporteve të Auditimit janë liruar nga detyra pikërisht për shkeljet dhe konstatimet nga keto raporte. Në vijim të Raportit për DRSHTRR Shkodër, është pasuar edhe nga raporti i DRSHTRR Tiranë dhe Durrës të cilat në mbështetje me shkeljet e konstatuara është marrë masë “Lirim nga detyra” për punonjesit: z. R. A, z.M. T, z. A. B.”.*

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë të pretenduar nga ankuesi.**

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

F. P ka qenë i punësuar pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR) Shkodër dhe ka mbajtur detyrën e Kryetarit të Degës së Financës, nga data 04.08.2015 deri me datë 26.12.2018.

---

<sup>6</sup> Referuar shkresave me: nr.18408/1 prot., datë 04.08.2019 dhe nr.2995 prot., datë 10.09.2019.



Me datë 27.08.2018 në DRSHTRR Shkodër, mbi bazën e sinjalizimit<sup>7</sup> është paraqitur grupi i investigimit të DPSHTRR me objekt investigimin e dokumentacionit të invalidëve të cilët përfitojnë përjashtim nga TVMP-ja për vitin 2017 e deri në Qershor 2018, faktuar nëpërmjet procesverbalëve të mbajtur: me nr.3475 prot., datë 27.08.2018, me nr.3567 prot., datë 31.08.2018 dhe me nr.3570 prot., datë 31.08.2018.

- Pas kryerjes së investigimit, nëpërmjet Urdhërit nr.1085, datë 24.09.2018 “Pezullim nga detyra”, Drejtori i Përgjithshëm ka pezulluar nga detyra F. P, me detyrë Kryetar i Degës së Financës deri në përfundimin e misionit të auditimit.
- Me Urdhërin nr.1085/2, datë 24.09.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPSHTRR është miratuar Programi i Auditimit në DRSHTRR Shkodër, me objekt auditimi: “Auditim i pjesshëm i veprimtarisë së subjektit” dhe periudhë auditimi nga data 24.09.2018-05.10.2018.
- Referuar procesverbalit me nr.3845 prot., datë 26.09.2018 të grupit të investigimit nga DPSHTRR, rezulton se janë kontrolluar dokumentat e invaliditetit dhe faturat e pagesës së taksave për vitin 2017 dhe vitin 2018, dhe janë verifikuar 199 raste për vitin 2017 dhe 107 raste për vitin 2018.
- Me Urdhërin nr.1085/3, datë 17.10.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm “Për shtyrjen e afatit të pezullimit nga detyra”, është shtyrë afati i pezullimit nga detyra për z.P deri në një urdhër të dytë.
- Nëpërmjet shkresës me nr.19693 prot., datë 15.11.2018, DRSHTRR Shkodër është njohur me Raportin Final të Auditimit, i cili ka konstatuar një dëm ekonomik të shkaktuar në shumën 1.016.482 lekë nga përjashtimi i TVMP-së së kategorisë së invalidëve, për shkak të moszbatimit në mënyrë të përsëritur të detyrave funksionale në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloren e institucionit nga F. P, si dhe është rekomanduar rishikimi i marrëdhënieve të punës me këtë punonjës.
- Në zbatim të sa mësipër, me datë 20.12.2018 është mbajtur takimi lidhur me bisedimet për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me z.P, ku të dyja palët kanë shprehur pretendimet lidhur me rishikimin e kësaj marrëdhënieje pune, fakt i cili reflektohet në procesverbalin e mbajtur në takim.
- Ndërkaq, në vijim të këtij takimi, nëpërmjet shkresës me nr.20310/3 prot., datë 26.12.2018, Urdhër nr.1430 “Për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës pa shkaqe të justifikuara” janë zgjidhur marrëdhëniet e punës me ankuesin.

Ankuesi duke mos rënë dakord me vendimin për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës ka ngritur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila me Vendimin nr.598 (2402) datë 13.05.2019 ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë duke i dhënë dëmshpërblimet përkatëse sipas ligjit për zgjidhje të kontratës së punës me efekt të menjëhershëm pa arsye dhe pa shkaqe të justifikuara, vendim i cili nuk ka marrë formë të prerë.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit dhe kronologjisë së ngjarjeve dhe fakteve, rezulton se:

---

<sup>7</sup> Deklarim i Institucioneve sipërcituar.

Adresa: Rruga e Durrësit, Kodi postar 1001, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër ka regjistruar procedimin penal me nr.1819, të vitit 2017 dhe ka marrë vendimin “Për sekuestrimin e dosjeve të automjeteve të dyshuara me të cilat është kryer veprimtari e kundraligjshme nga punonjës pranë DRSHTRR Shkodër”. Kjo çështje është referuar nga Krimi Ekonomik në Policinë e Shtetit dhe kjo e fundit ka bërë kallëzim pranë Prokurorisë.
- Nëpërmjet komunikimit shkresor të DPSHTRR dhe DRSHTRR Shkodër me Prokurorinë informohemi se ky procedim penal është ende në fazën e hetimeve dhe aktualisht nuk ka një vendim konkret nga organi i akuzës lidhur me veprat penale “Shpërdorim detyre” dhe “Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”.

Rregullorja “Për Organizimin dhe Funkzionimin e DPSHTRR”, me nr.778, datë 19.06.2018, në nenin 21 citon se: *“Drejtoria e Investigimit Administrativ, ka si mision të kryejë verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë dhe/ose kallëzimeve për praktika abuzive, korruptive e arbitrare, të identifikojë punonjësit e administratës së DPSHTRR-së, të cilët me veprime apo mosveprime kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, të përgatisë rekomandime për çështje, përfshirë dhe llojin e masave ndaj autorëve, si dhe të ndërgjegjësojë institucionet publike në luftën kundër korrupsionit. Ajo ushtron veprimtarinë duke përdorur forma, metoda e mjete pune informative, të hapura e të mbyllura, të mbështetura në ligj, sipas standarteve të ngarkuara në ligji. Këto procedura miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili kërkon shpjegime për mënyrën e zbatimit të tyre”.*

Drejtoria e Auditimit në DPSHTRR ka detyrë funksionale pikërisht të ushtrojë kontroll në Drejtoritë e tjera Rajonale dhe në këtë kuadër është ushtruar dhe kontrolli në DRSHTRR Shkodër. Drejtoria e Auditimit pranë DPSHTRR punon e pavarur dhe kontrollon veprimtarinë dhe punën e DRSHTRR Shkodër. Për këtë shkak DRSHTRR Shkodër nuk kishte si të influenconte pranë saj dhe të ndikonte në rekomandimin për largimin e ankuesit nga puna.

Referuar pretendimit të subjektit ankues, se nga ana e punëdhënësit ishte realizuar një auditim i qëllimshëm në DRSHTRR vetëm për ta larguar atë nga puna, Komisioneri, vlerëson se nisur nga kronologjia e fakteve dhe rrethanave sipërcituar, konstatohet se auditimi nuk mund të ishte tendencioz, pasi, ai është realizuar pasi Prokuroria kishte iniciuar një hetim, në vitin 2017, lidhur me dëmin financiar të shkaktuar në shumën 1.016.482 lekë. Ndërsa, audimi pranë DRSHTRR Shkodër është zhvilluar më mbrapa, në shtator 2018.

Për analogji të rastit, DPSHTRR ka sjellë në cilësi prove dhe 3 praktika të ngjashme me atë të ndjekur për subjektin ankues. Kështu, për 3 punonjës të DRSHTRR Durrës, (z.M.T, z.R.A dhe z.A.B), të cilët janë gjetur në shkelje në Raportet e Auditit dhe është rekomanduar largimi i tyre nga puna, DPSHTRR ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me ta.

Në kontekst të sa më sipër, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk është ekspozuar para një trajtimi të pabarabartë dhe disfavorizues nga ana e DPSHTRR, dhe as nga ana e DRSHTRR Shkodër.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur*

Adresa: Rruga e Durrësit, Kodi postar 1001, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)



*në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në nenin 12/1/c) të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se nuk kemi një trajtim të pafavorshëm të subjektit ankues, që të ketë ardhur pas një auditimi tendencioz, sikundër kishte pretenduar ankuesi.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se DPSHTRR nuk ka ndërmarrë veprime që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj ankuesit, ose që e kanë ekspozuar atë, ndaj një trajtimi tendencioz dhe jo të barabartë, në krahasim me persona të tjerë, që ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme me të.

Në mungesë të një trajtimi tendencioz, të pafavorshëm e të pabarabartë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e DPSHTRR dhe DRSHTRR Shkodër për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

Në mungesë të trajtimit të pabarabartë, Komisioneri gjykon se nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkakun e bindjes politike të pretenduar nga ankuesi.

## **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 9, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), nenin 1, nenin 7, pika 1,

nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11,të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “bindjeve politike” të F. P, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR) Shkodër dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR).
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Fusha: Punësim  
Shkaku: Bindjet politike